



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.3.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 25.02.2021.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Edlira Bode, Arben Kamami, Rolant Xhelilaj, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Ervis Meço, Edmond Stojku, Halil Jakimi dhe Amra Barova.

Marrin pjesë:

Gramos Sulaj – specialist për armatimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë
Arben Nasufi – Komisar, ekspert i fushës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë
Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrera – Drejtoreshë Juridike Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Të nderuar kolegë, mirmëngjes!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me këtë rend dite:

Së pari, miratimin e procesverbalit të datës 25.02.2021. Kush është dakord me miratimin e procesverbalit të kësaj date? Dakord.

Miratohet procesverbali.

Së dyti, shqyrtimin e projektligjit “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”. Komisioni e shqyrton këtë nismë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Relator kemi kolegun Rolant Xhelilaj.

Të ftuar nga Ministria e Brendshme, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, kemi zotin Gramoz Sula, specialist për armatimin. Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale kemi të ftuar zonjën Geraldina Prodani, sekretare e Përgjithshme, dhe zonjën Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë Juridike në këtë ministri.

Sipas protokollit, këtë projektligj ne e sollëm në komisionin tonë për ta shqyrtuar dhe për ta parë, sepse ka një dimension shëndetësor në përdorimin e mjeteve piroteknike.

Fjalën po ia jap përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtorit Gramoz Sulaj. Zoti Sulaj, fjala për ju.

Gramoz Sulaj – Mirmëngjes!

Më lejoni të parashtroj aktivitetin që ka bërë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria e Brendshme në hartimin e draftit paraprak, që ju po e diskutoni sot. Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë kanë ushtruar ndikimin e tyre në përgatitjen dhe reflektimin e të gjithave të dhënave dhe standardeve që kërkohen në hartimin e një projektligji.

Më lejoni që në vijim të diskutimeve konkrete të çështjes, t’ia lë fjalën ekspertit për çështjet e sigurisë, zotit Nasufi.

Enver Roshi – Të lutem, na thaj edhe një herë emrin e kolegut?

Gramoz Sulaj – Arben Nasufi.

Enver Roshi – Dakord, fjala për ju zoti Arben.

Arben Nasufi – Përshëndetje!

Unë quhem Arben Nasufi dhe jam në gradën “Kryekomisar”. Kam qenë anëtar i grupit të punës në hartimin e projektligjit për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë. Ky projektligj është hartuar në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 164, datë 01.11.20218, i cili ngriti grupin e punës që kryesohej nga zëvendësministri i Mbrojtjes, kishte dy përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, një përfaqësues nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, kishte përfaqësues nga Ministria e Brendshme, nga Policia e Shtetit, që e përfaqësoja unë, kishte përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, si dhe përfaqësues nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjetikës. Janë këta përfaqësues, të cilët ky projektligj i prek, i ngarkon me detyra dhe me përgjegjësi për zbatimin e tij në praktikë.

Policia e Shtetit ka dhënë kontributin e saj në hartimin e këtij projektligji dhe fusha e përgjegjësisë që ka policia ka të bëjë në lidhje me magazinimin, tregtimin dhe asgjësimin e lëndëve piroteknike (fishekzjarrë).

Fushat e tjera të hedhjes në treg, të rrezikshmërisë, të kapacitetit të depove që mund të jenë u takojnë institucioneve të tjera.

Në lidhje me magazinimin, përdorimin dhe asgjësimin e lëndëve piroteknike, jemi të gatshëm të diskutojmë për të dhënë kontributin tonë në lidhje me miratimin e këtij projektligji.

Enver Roshi – Faleminderit!

Atëherë, sipas procedurës, po ia kaloj fjalën relatorit, zotit Rolant Xhelilaj.

Fjala për ju, zoti Rolant.

Hapeni mikrofonin, zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj – Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë shqyrton sot projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në përputhje me nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji patjetër është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në përgjithësi qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një sistemi efikas të kontrollit, mbikëqyrjes së tregut, vlerësimit të përputhshmërisë së artikullit piroteknikë, përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të artikujve, në mënyrë që të garantohet përputhshmëria e tyre me kërkesat ligjore.

Qëllimet janë: heqja e kufizimeve që bllokojnë tregtimin, prodhimin dhe shitjen, duke mirëpërcaktuar standardet e sigurisë në përdorim dhe në shitje; rritja e standardeve dhe përafrimi

me legjislacionin e BE-së nëpërmjet marketingut, kategorizimit e të tjera; ndarja e artikujve piroteknikë nga lëndët plasëse për përdorim civil dhe ofrimi i regjimit të strukturuar të zinxhirit të furnizimit, si dhe ndarja e përgjegjësisë së institucioneve shtetërore në proceset e mbikëqyrjes së tregut dhe trupave certifikuese nëpërmjet përcaktimit të autoriteteve kompetente dhe fushave të përgjegjësisë për të përcaktuar në një periudhë afatshkurtër përputhjen e legjislacionit tonë me atë të vendeve të BE-së. Në fakt, për Komisionin e Shëndetësisë ky projektligj ka rëndësi, për arsye se ai sjell përmirësime në shëndet dhe në mjedis, pasi përmirësimi i standarteve të sigurisë për konsumatorët sjell më pak aksidente gjatë prodhimit, përdorimit të artikujve piroteknikë, uljen e nivelit të zhurmave, ndotjen akustike, ndotjen e materialit, pra ndotësit e ajrit, që lëshohen nga këta artikuj. Rritja e sigurisë dhe evidentimi i kontrollit të fishekzjarreve në vija të përgjithshme dhe afatgjatë do të ndikojë pozitivisht, për mendimin tonë, në sigurimin e qëndrueshmërisë për një mjedis më të pastër.

Komisioni ynë, si komision për dhënie mendimi, vlerëson se qëllimi i këtij projektligji, që ka synim kryesor krijimin e një sistemi efikas kontrolli, duhet bërë në përputhje të plotë edhe me sigurimin e detyrimeve të operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të këtyre artikujve, që të garantohet përputhshmëria e tyre me kërkesat ligjore në fuqi.

Ftoj komisionin ta miratojë projektligjin.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zoti Roland!

Hapim diskutimet për deputetët e nderuar.

Nëse keni pyetje apo diskutime për projektligjin, fjala është për ju.

A keni pyetje për projektligjin?

Atëherë, unë kam pyetje për prezantuesit e projektligjit.

Këtu u mëshua shumë aspekti i asgjësimit të artikujve piroteknikë. Ne duam të dimë se si administrohet hedhja në treg e artikujve piroteknikë dhe si mbikëqyret përdorimi i mjeteve piroteknike në popullatën shqiptare.

Si është parashikuar asgjësimi tyre, në kuptimin e ndotjes së mjedisit, sepse në Shqipëri ka ngjarje të dhimbshme? Kujtojmë një aksident ose mungesë vëmendjeje, siç ishte Gërdeci, me përmasat madhore që mori në dëme njerëzore, materiale dhe mjedisore. Kjo nuk do të jetë në përmasa të tilla, por ne duhet t'u vëmë frerë fenomeneve të tilla, që në të ardhmen të mos kemi

probleme me zhdëmtimin e artikujve piroteknikë, kur ato të arrijnë sasi të mëdha, pra duhet të dimë si do të procedohet për asgjësimin e tyre.

Pra, si administrohet hedhja në treg? Nga kontrollohet hedhja në treg?

Si bëhet asgjësimi i tyre?

Nga ana juaj u fol shkurt, por ne do të donim që ju, si propozues të projektligjit, të argumentoni specifikisht për të minimizuar apo për të mos ndodhur fare aksidente në njerëz, por edhe në aspekte të tjera shëndetësore, si zhurma e fishekzjarreve, që hidhen në çdo periudhë të vitit, që hedhja e tyre të jetë më e lokalizuar, të mos përdoren nga fëmijët, etj.

A mund ta elaboroni pak këtë fushë, ju lutem?

Nga Ministria e Brendshme, zoti Arben Nasufi.

Arben Nasufi - Përshëndetje! Jam Arben Nasufi, kryekomisar.

Në lidhje me hedhjen në treg nga autoritetet e tjera që merren me përputhshmërinë dhe hedhjen në treg të lëndëve plasëse, unë do të ndalem te pika e dytë, që ju, i nderuar, përmendët, që ka të bëjë me administrimin, përdorimin dhe pjesën fundore që është asgjësimi i lëndëve piroteknike, ose fishekzjarrët. Në lidhje me kapacitetet e administrimit në depo, mbajtja e sasisë dhe e kushteve teknike që përdoren për magazinim, pra, se sa kilogramë, apo sa tonë do të mbahen në një magazinë, përcaktohet nga autoriteti që quhet RISHM-i dhe që varet nga një ministri tjetër dhe është një nga kriteret mbi bazën e të cilave Ministria e Brendshme kontrollon sasinë e vendosur në këtë depo, e cila ka kushte të përcaktuara në një rregullore të veçantë të miratuar nga ministri i Brendshëm, që është rregulloja 229, e cili funksionon, por me daljen e këtij ligji, nëse miratohet, do të duhet të bëhet një rregullore e re në zbatim të nenit 15, pika 13 të këtij projektligji, miratuar nga ministri përgjegjës për Rendin dhe Sigurinë Publike.

Në lidhje me përdorimin e lëndëve piroteknike, këto janë të klasifikuara në kategori dhe kemi kategoritë F1, që janë në përdorim në ambientet e mbyllura, për shembull ato lëndë piroteknike që vendosen mbi tortën për ditëlindjen e fëmijëve, që nuk kanë fare rrezikshmëri, po futem në çështje teknike meqenëse kam mësuar edhe nga kolegët gjatë grupit të punës. Kategoritë F2 janë fishekzjarrë që përdoren në ambientet e jashtme në një distancë të shkurtër, me zhurmë të ulët të këtyre mjeteve dhe mund të përdoren në zbatim të këtij projektligji nga presona mbi 16 vjeç, pra me përgjegjësi jo të plotë për të vepruar, në zbatim të veprimit, ose pjekurisë së personit. Pra, rrezikshmëria është e ulët. Kemi kategorinë F3 që ka fishekzjarre me një zhurmë jo të lartë dhe përdoret nga qytetarë mbi moshën 18 vjeç, pastaj kur futemi në kategoritë profesionale F4

dhe që kanë zhurmë të lartë, apo T1, T2, që janë profesionale, duhet patjetër të këtë një certifikim, që për herë të parë e zgjidh ky projektligj, pasi në ligjin e mëparshëm, që ishte një shtesë e ligjit “Për përdorimin e lëndëve plasëse” mungonte mënyra e trajnimit dhe kush do ta lëshonte këtë certifikatë të përdorimit. Dhënia e lejeve për përdorimin e fishekzjarrëve të rrezikshme, ose F4 dhe ato profesionale jepet nga autoritetet vendore të zgjedhura, që janë bashkitë e vendit.

Kontrolli do të bëhet nga të gjitha institucionet, nga punonjës të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera, qoftë në magazinim, qoftë në përdorim, qoftë dhe në hedhjen në treg, kur këto ndryshojnë cilësinë.

Në momentin kur një mall, që ka të bëjë me lëndët piroteknike, e humbet vlerën, vetinë e tij ose afatin e skadencës, bëhet i rrezikshëm, nuk duhet të mbahet dhe të administrohet nëpër depo ose nuk mund të tjetërsohet dhe të përputhet me direktivat e këtij projektligji apo të BE-së, atëherë Policia e Shtetit lëshon një autorizim për asgjësimin e kësaj lënde.

Për sa i përket asgjësimit, është i përcaktuar në rregulloren aktuale nr.229 të ministrit të Brendshëm, por nga studimet që kemi pasur dhe në komisionet e këtij grupi pune është diskutuar që do të këtë edhe një projekt-VKM për asgjësimin e lëndëve të rrezikshme, dhe nëse ajo e përfshin edhe këtë kategori, do të ishte shumë mirë; nëse jo, atëherë do të përfshihet në urdhrin e ministrit të Brendshëm, duke pasur në konsideratë edhe ndotjen e mjedisit dhe duhet gjetur forma për asgjësimin e saj.

Enver Roshi - Faleminderit!

Meqënëse jemi këtu, kush e përcakton skadencën e artikujve piroteknikë? Ndoshta tregtari nuk e deklaron skadencën e tyre. Kush e kontrollon?

Së dyti, kush e bën transportin e artikujve piroteknikë? Pra, a ka një procedurë të tyre që...?

Arben Nasufi - Ka një procedurë. Për çdo lëvizje të lëndës piroteknike, edhe sot është urdhri nr.229 që e përcakton, lëshohet një autorizim që do të importohet ose do të inspektohet në një vend tjetër. Për çdo ngarkesë ka kushte e kritere; ka makinë me ADR, të miratuar nga punonjësi i shërbimit që duhet ta drejtojë këtë makinë dhe punonjës të sigurisë që bëjnë shoqërimin e lëndës edhe sot që flasim, por me rishikimet patjetër që do të përmirësohet.

Për sa i përket asgjësimit, është e përcaktuar në projektligj që çdo paketë duhet të këtë gjuhën shqipe, afatin e prodhimit, afatin e skadimit dhe shumë emërtime të tjera që autoriteti i përputhshmërisë ose struktura përgjegjëse hedh në treg. Në momentin kur ngarkesa është e skaduar, është vetë subjekti që i bën kërkesë policisë për asgjësimin e saj, se sa mund të jetë për

t'u asgjësuar. Nga praktika, deri tani, përveç një rasti të një subjekti prodhues, i cili kishte një ngarkesë të vogël (kjo ka ndodhur para disa vitesh, para se të hartohej ky projektligj), nuk kemi pasur ndonjë rast tjetër asgjësimi.

Enver Roshi - Me sa po kuptoj, ju keni struktura përgjegjëse që merren me gjurmimin e artikujve piroteknikë, pra ka një regjistër, një databazë për të gjithë artikujt piroteknikë që ju kontrolloni dhe ndiqni? A ka një strukturë të tillë në ministrinë tuaj?

Arben Nasufi - Çdo strukturë, që nga hedhja në treg, ka regjistrin e saj, pra është përgjegjësi e strukturave që e administrojnë këtë lëndë, që nga linja e prodhimit, autoriteti i përputhshmërisë që e hedh në treg, subjekti që e magazinon dhe e tregon, pra që ka regjistra të posaçëm dhe institucionet përgjegjëse që i kanë dhënë licencimet kanë autoritetin për të kontrolluar dhe për të mbajtur regjistrin e gjurmimit.

Enver Roshi- Në mendimin tonë, si komision, dhe timin personal duket që artikull piroteknik, pavarësisht se është një ligj i arrirë në krahasim me ligjin e mëparshëm, ka një decentralizim dhe ka shumë sektorë që merren me këtë, por frika qëndron që mungesa e një disipline dhe një strukture të veçantë, e cila merret vetëm me këtë dhe e kontrolluar nga Ministria e Brendshme, e bën këtë ligj fleksibël, shumë të dobët në implementimin e tij dhe rrit rrezikshmërinë të qytetarët. Kjo është ajo që unë parandiej, sepse shoh që këto artikuj piroteknikë kanë efekte negative shëndetësore, sidomos kur përdoren nga mosha nën 16 vjeç, që ua hedhin prindërve, pleqve, grave shtatzëna në rrugë, duke provokuar zhurma. Kostoja e kësaj ndërhyrjeje për efekte shëndetësore është kosto zero, por me pak ndërhyrje ne mund të rritim dhe të kemi efekte shëndetësore pozitive, sepse efekti i zhurmës që prodhojnë këto mjete piroteknike është shumë negativ të gratë shtatzëna, të pleqtë apo të njerëzit e tjerë. një gruajë shtatzënë që mund t'ia hedhë 14 vjeçar të këmbët mund të trembet dhe të provokojë abort nga zhurma e prodhuar. Kjo ishte arsyeja pse unë këmbëngula për ta sjellë këtë ligj në Komision e Shëndetësisë. Ndonëse duket në ligj i përcaktuar për ministrinë tuaj, implemtimi, zbatimi dhe hedhja në treg e tyre ka efekte shëndetësore negative dhe ne duam që të disiplinohen me rreptësi prindërit e fëmijëve nën moshën 16 vjeç dhe të vihen para ligjit. Ju keni bërë një klasifikim të caktuar këtu dhe këtu e kisha problemin bashkë me kolegët.

A ka gjë tjetër?

Po, zoti Arben.

Arben Nasufi- Këto janë në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian dhe me rregulloret. Ne nuk kemi bërë ndonjë shpikje vetë, por vetëm kemi marrë dhe kemi përputhur pjesërisht, duke pasur edhe në konsideratë shqetësimin tuaj, dhe kemi përcaktuar përdorimin e tyre vetëm në një afat, që mund të jetë Viti i Ri, të cilin e ka të përcaktuar projektligji. Pra, nuk do të isha dakord për hedhje gjatë gjithë kohës të këtyre lëndëve piroteknike. Megjithatë, kjo është vendimmarrja juaj. Ne kemi dhënë kontributin tonë si Polici e Shtetit dhe si Ministri e Brendshme. E thashë edhe në fillim të fjalës sime që ky ishte urdhër i Kryeministrit dhe ky projektligj drejtohet dhe udhëhiqet nga Ministria e Mbrojtjes, ku ne kemi dhënë asistencën dhe mbështetjen tonë për të dhënë garanci të përgjegjësive që merr Policia e Shtetit për ta implementuara.

Jua faleminderit!

Enver Roshi – A ka dikush nga kolegët për të shtuar diçka? Jo, nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit. Kush është dakord? Kundra dhe abstenime nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen. Këtu ne, si komision, kemi disa sugjerime.

Atëherë, ne i sugjerojmë komisionit përgjegjës të ketë parasysh: neni 4, pika 2, e cila ndalon ose kufizon zotërimin e përdorimit dhe/ose shitjen për publikun e gjerë të fishekzjarrëve dhe kategorive 2 dhe 3, të artikujve piroteknikë të teatralë dhe artikuj të tjerë piroteknikë. Këto kategori duhen riparë dhe përcaktuar qartë, pasi nuk janë te neni 5, i cili përcakton kategorinë e artikujve piroteknikë. Në pikën 2 të nenit 6, në të cilën thuhet: “Për arsye të sigurisë publike, mund të rriten kufijtë e moshës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni”; kjo është paqartë dhe e paplotësuar. Në cilat raste do të ndodhë dhe nga kush? Në pikën 8 të nenit 7, në të cilin thuhet: “Në rast se është e nevojshme, prodhuesit për artikujt e hedhur në treg nga ata të hetojnë dhe mbajnë një regjistër nga ankesave për artikuj piroteknikë që nuk plotësojnë kriteret”. Sugjeroj që të bëhet e detyrueshme për të qenë në përputhje edhe me pikën 8 të nenit 11; pikat 2, 3 dhe 8 të nenit 15, pasi bie në kundërshtim me pikën 1/a të nenit 6; pikën 1/a të nenit 28, pasi është e paqartë, pikën 2 të nenit 29, pasi duhet të jetë me kohë të përcaktuar dhe jo të lihet në dorë të autoritetit mbikëqyrës. E njëjta problematik është edhe te pika 3/a e nenit 31.

Gjithashtu, për teknikë legislative sugjeroj që përcaktimi “të kryejë inspektimin në përputhje me parashikimin e ligjit nr. 10 433, datë 16.16.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i përdorur në nenin 26, pika V, dhe nenin 31, pika 2, të zëvendësohet me përcaktimin

“sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për inspektimin”. Ky zëvendësim sugjeroj të bëhet në të gjitha dispozitat e projektligjit, ku janë përdorur si referim ligje të caktuar. Për shembull, neni 22 dhe pika 4 e nenit 25. Këto janë sugjerimet e komisionit tonë për komisionin përgjegjës, të cilat mendojmë se do të merren parasysh. Gjithsesi, e thashë që impakti negativ i zhurmës është i jashtëzakonshëm mbi të gjitha shtresat, mbi të gjithë popullsinë dhe mbi të gjitha moshat, veçanërisht për moshat e vjetra dhe për gratë shtatzëna.

Unë them ta kalojmë projektligjin sipas variantit të ardhur nga komisioni përgjegjës dhe me sugjerimet që i propozuam komisionit përgjegjës. A jeni dakord për ta kaluar projektligjin kështu?

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit për pjesëmarrjen dhe një ditë të këndshme!

Falënderoj të ftuarit nga Ministria e Brendshme dhe nga Ministria e Shëndetësisë!

E mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit! Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Arben Kamami

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Joana Bitri